



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR  
Drejtoria e Përgjithshme



Nr. 21691 Prot  
2

Tiranë, më 12.03.2020

**Lënda:** Sqaruese mbi trajtimin e të sëmurëve kronikë që përfitojnë barna me rimbursim që tregtohen në farmacitë spitalore

Në mbështetje të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të shkronjës “r”, të pikës 1, të nenit 10, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 05.03.2014, “Për miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”, të udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit nr. 11, datë 16.07.2019 “Për përshkrimin e recetës elektronike nga mjekët specialistë të spitalit me barnat nga lista e barnave të rimbursuara, që tregtohen nga farmacitë e spitalit dhe procesin e administrimit nga DAPSHET/DRF”, të urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 159, datë 11.03.2020, “Për kufizimin e lëvizjes së pacientëve shoqëruesve dhe/ose familjarëve dhe organizimin e shërbimeve në institucionet e kujdesit shëndetësor ku kryhen vizita dhe konsulta ambulatorë” dhe të Kontratës “Për lëshimin e recetës me rimbursim nga mjeku specialist për barnat që tregtohen në farmacinë e spitalit”, në zbatim të urdhërit Nr. 131 datë 12.03.2020 nr. prot.2169 të Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit, me qëllim kufizimin e prezencës së pacientit/shoqëruesit dhe/ose familjari i tij në spital, për vizitë spitalore, për marrjen e recetës me rimbursim dhe në DRF/DAPSHET, për konfirmim e recetës dhe të alternativës së barit me rimbursim, ju sqarojmë se:

**A. Kur pacienti përfiton alternativën e parë të barit nga Lista e Barnave të Rimbursueshme që tregtohen në farmacitë spitalore:**

1. Ky proces të realizohet vetëm pas një ndërveprimi ndërmjet DRF/DAPSHET - Mjek Specialist - Spital - Pacient - Farmacia e Spitalit.
2. Informacioni për pacientët (NID) të sigurohet nga Sektori i Informatikës dhe nga Mjekët e Përgjithshëm/Mjekët e Familjes.
3. Mjekët specialist duke patur të dhënat e pacientit (NID), të gjenerojnë recetën elektronike dhe ti dërgojnë DRF/DAPSHET kodet e këtyre recetave duke përdorur

sisteme elektronike online, SMS dhe çdo komunikim tjetër që vlerësohet i arsyeshëm nga mjeku.

4. DRF/DAPSHET, pasi të kenë marrë kodet e recetës për secilin pacient dhe ID të pacientit, të procedojnë me konfirmimin në sistemin elektronik të recetës me rimbursim, eRX.
5. Pas këtyre veprimeve pacienti / shoqëruesi dhe / ose familjari i tij, të njoftohet me telefon nga DRF/DAPSHET dhe të paraqitet në farmacinë e spitalit me kod recete dhe ID e pacientit, për të tërhequr barin/barnat me rimbursim.
6. Recetat me rimbursim të printohen nga DRF/DAPSHET dhe të dërgohen brenda ditës në farmacinë e spitalit.

#### **B. Kur pacienti përfiton alternativën me bashkëpagesë të barit nga Lista e Barnave të Rimbursueshme që tregtohen në farmacitë spitalore:**

Në këto raste theksojmë se, duhet të arrihet kufizimi i dërgimit të pacientëve për vizitë spitalore tek mjeku specialist i spitalit, por pacienti / shoqëruesi dhe / ose familjari i tij, mund të paraqitet me kod recete dhe ID e pacientit, pranë DRF/DAPSHET për të kryer bashkëpagesën dhe në farmacinë e spitalit për të tërhequr barin/barnat me rimbursim.

1. Receta me rimbursim të plotësohet për një periudhë 2 Mujore.
2. DRF/DAPSHET të vlerësojnë secilin rast, hap pas hapi duke minimizuar problematikat në sistem.

Në rastet e prezencës së pacientëve pranë institucioneve shëndetësore publike duhet të respektohet në mënyrë rigorozë perimetri i sigurisë dhe distanca midis pacientëve dhe ofruesve të shërbimit të jetë jo më pak se 1.5 metër distancë nga njëri-tjetri.

Në të gjitha rastet e mësipërme trajtimi i pacientëve do të bëhet në zbatim të protokolleve të përdorimit të barnave, kufizimeve të Listës së Barnave të Rimbursueshme dhe akteve të tjera në fuqi.

Ngarkohen Drejtoritë Rajonale / DAPSHET / Degët e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të cilët në koordinim me Drejtoritë Rajonale / Njësitë Vendore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të marrin të gjitha masat për zbatimin e shkresës sqaruese si dhe njoftimin e të gjithë dhënësve të shërbimit shëndetësor publik spitalor të kontraktuar nga ana e tyre.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Rudina Degjoni**

